



Oda e Stomatologëve të Kosovës  
Rr. Kosta Novaković p.n.  
Kontenieri III, Nr.214  
Prishtinë



SH.P.K. Dental DAY  
Rr. Ymer Aliu, BL-A1-Hyrja  
Z2, KT-P-Nr.23  
Prishtinë

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI NDËRMJET ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS DHE SH.P.K. DENTAL DAY

### Neni 1 Qëllimi

1. Oda e Stomatologëve të Kosovës dhe SH.P.K. Dental Day (në vazhdim *Palët*) shprehin vullnetin dhe mirëkuptimin e tyre për bashkëpunimin e qëndrueshëm në fushën e shkëmbimit të informacioneve, përvojave dhe organizimit të përbashkët të trajnimeve, kurseve, seminareve, punëtorive, simpoziumeve, konferencave dhe kongreseve (në vazhdim *Ngjarjet*).
2. Bashkëpunimi reciprok i të dy palëve nënshkruese bëhet me qëllim të mbështetjes së procesit të avancimit profesional të profesionistëve të stomatologjisë dhe lehtësimit të zhvillimeve të programeve të trajnimit.

## **Neni 2**

### **Fushëveprimi**

Ky bashkëpunim do të fokusohet në shkëmbimin e informatave dhe zbatimin e aktiviteteve lidhur me organizimin e trajnimeve, mbështetjes në publikime për avancim të stomatologjisë, promovim të produkteve inovative në fushën e stomatologjisë, mbështetje në organizimin e panairëve dhe aktiviteteve të ndryshme promovuese në fushëveprimtarinë e palëve.

## **Neni 3**

### **Angazhimet e Odës së Stomatologëve të Kosovës**

Oda e Stomatologëve të Kosovës do të angazhohet që:

- (a) Të luaj rol proaktiv në vlerësimin e nevojave për trajnim të stomatologëve dhe teknikëve dentarë dhe të stomatologjisë dhe të njoftoj SH.P.K. Dental Day me rezultatet e këtij procesi.
- (b) Të propozoj tema dhe programe trajnimi për trajnimin e stomatologëve, infermiereve dhe teknikëve dentarë.
- (c) Të bashkëpunoj me SH.P.K. Dental Day në organizimin e panairëve dhe promovimit të palëve nënshkruese, që sjellin risi në fushën e stomatologjisë.
- (a) Të bashkëpunoj me SH.P.K. Dental Day në fushën e publikimeve dhe promovimit të palëve nënshkruese.

## **Neni 4**

### **Angazhimet e SH.P.K. Dental Day**

SH.P.K. Dental Day do të angazhohet që:

- (b) Të përfshihet në bashkëpunim me OSK-në në procesin e hartimit të programit të trajnimeve.
- (c) Të mbështesë në organizimin e aktiviteteve për zhvillim profesional të profesionistëve të stomatologjisë përmes sjelljes së ekspertëve dhe profesionistëve me risi në fushën e stomatologjisë.
- (d) Të bashkëpunoj me OSK-në në fushën e publikimeve dhe promovimit të palëve nënshkruese.
- (e) Të bashkëpunoj me OSK-në në organizimin e produkteve dhe pajisjeve inovative në fushën e stomatologjisë.

**Neni 5**  
**Reklamimi i ndërsjelltë**

Palët obligohen ta vendosin logon dhe linkun e web-faqes së njëra tjetës në web-faqet e tyre.

**Neni 6**  
**Ndarja e shpenzimeve sipas marrëveshjes së palëve**

Palët zotohen që me marrëveshje të ndërsjelltë t'i ndajnë detyrat dhe obligimet e përgjithshme në rastet kur organizimi i *Ngjarjeve* është i përbashkët, Ndarja e shpenzimeve për organizimin e *Ngjarjeve* (ku përfshihen sallat, ligjeruesit e ftuar, drekat dhe darkat për ligjerues të ftuar dhe mysafir të ftuar, tj.) bëhet sipas marrëveshjes paraprake.

**Neni 7**  
**Miratimi, ndryshimet dhe hyrja në fuqi**

Ky memorandum është i vlefshëm derisa *Palët* të mos kenë kërkuar shfuqizimin e tij. Palët mund të ndryshojnë ose të plotësojnë dispozitat e këtij Memorandumi, kur paraprakisht dakordohen.

**Neni 8**

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandum zgjidhet me mirëkuptim mes *Palëve*.

**Neni 9**

Ky Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

**Prishtinë, 21.08. 2019**

**Për Odën e Stomatologëve të Kosovës**

Prof.Dr. Blerim Kamberi,  
Kryetar i OSK-së



**Për SH.P.K. Dental Day**

Z. Artan Kryeziu,  
Drejtor Ekzekutiv

